



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 237

Tiranë – E premte, 5 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10666, datë 30.11.2017	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 13145
Dekret i Presidentit nr. 10690, datë 18.12.2017	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 13145
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 203, datë 18.12.2017	Për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”..... 13146
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 204, datë 18.12.2017	Për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike 13155
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 205, datë 18.12.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 13156
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 206, datë 18.12.2017	Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullores “Mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë”..... 13157
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 207, datë 18.12.2017	Për miratimin e rregullores “Për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”..... 13157
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 208, datë 18.12.2017	Mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2017..... 13162

**DEKRET**

Nr. 10666, datë 30.11.2017

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Anisa Qamil Kurtaj
2. Sokol Vasil Kaçani
3. Gazmend Marash Vuktilaj
4. Marinela Gazmend Vuktilaj
5. Leonard Gazmend Vuktilaj
6. Marjana Mark Doda (Doda Prenga)
7. Aries Gëzim Hysa
8. Gevin Gëzim Hysa
9. Vangjel Petraq Xeka
10. Orjola Fatmir Xeka (Beshi)
11. Aleks Vangjel Xeka
12. Johan Vangjel Xeka
13. Velimir Vojo Popović
14. Pamisa Përparim Merka
15. Mario Mark Lëqejza
16. Izabela Hamdi Zenelaj (Ramaj)
17. Laureta Petraq Xhaferaj (Devija)
18. Hajdar Pëllumb Mema
19. Dennis Pëllumb Mema
20. Ded Martin Gjoli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET

Nr. 10690, datë 18.12.2017

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Isa Ramazan Ali (Aliu)
2. Renaldo Tarzan Myrselaj
3. Amina Renaldo Myrselaj
4. Hana Renaldo Myrselaj
5. Mimoza Gligo Popović (Prandvera)
6. Vanja Velimir Popović
7. Zyber Hysen Shkina
8. Izmir Mujdin Nela
9. Ivica Ranko Zlatičanin (Kerstoja)
10. Girida Agim Gajta
11. Petro Vangjel Xeka
12. Fatjona Prekë Volaj
13. Lindita Muhamet Sina
14. Stoiko Velo Rajçeviq (Simoja)
15. Andi Islam Tafa
16. Arben Mexhit Çipi
17. Rando Arian Vasa
18. Erald Jakup Harka
19. Dejan Sllavko Mikuliq
20. Zoranka Sllavko Mikuliq
21. Dejan Slllobodan Matanoviç
22. Dajana Stojan Šunjević
23. Daliborka Zhivo Radusinoviç
24. Artan Selman Cani
25. Censila Heke Caka
26. Altin Pëllumb Hazizaj
27. Joni Altin Hazizaj



28. Najada Artan Dushaj
29. Kiti Kamer Gruda (Hasani)
30. Besmira Muhamet Vidrica
31. Jesika Hysen Ademi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 203, datë 18.12.2017

**PËR MIRATIMIN E “KUSHTEVE TË
PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE
PËR KLIENTËT FUNDORË”**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, germa “h”; nenit 79 dhe nenit 94, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, pasi shqyrtoi relacionin mbi “Kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

1. Me vendimin nr. 66, datë 27.5.2016, bordi i ERE-s vendosi: Fillimin e procedurave për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.

2. Me shkresën nr. 429 prot., datë 1.6.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draftin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë” për opinion.

3. Në shkresën e saj me nr. 3788/1 prot., datë 16.6.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka paraqitur komentet e saj, lidhur me draftin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, të cilat janë shqyrtuar dhe reflektuar në vlerësim të secilës.

4. Në shkresën e saj me nr. 4528/1 prot., datë 13.6.2016, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka paraqitur komentet e saj, lidhur me draftin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, të cilat janë reflektuar në draftin e këtij akti.

5. Në shkresën me nr. A-DO/3391/1 prot., datë 24.6.2016, shoqëria OST sh.a. ka paraqitur komentet e saj, lidhur me draftin e “Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, të cilat janë reflektuar në këtë akt për aq sa janë gjendur në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORJA
MBI KUSHTET E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME ENERGJI
ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Këto rregulla kanë për qëllim të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të shërbimit të furnizimit të klientëve të energjisë elektrike, përmes vendosjes së kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike, të ofruar nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike.



Neni 2 Baza ligjore

Këto rregulla hartohen në mbështetje të nenit 79 dhe nenit 94, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

PJESA E DYTE TERMAT DHE KUSHTET

Neni 3 Përkufizime

Termat e përdorur në këto rregulla kanë kuptimin e mëposhtëm:

“Aplikues” do të thotë çdo person, i ndryshëm nga ankuesi, i cili kërkon të fillojë një veprim që kërkohej të institucionalizohet nga aplikimi.

“Ankues” do të thotë një person që depoziton një ankesë në ERE, për çdo veprim ose mosveprim të një personi, që është në juridiksionin e ERE-s për aktivitetin që kryen, siç parashikohet në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, i cili është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri.

“Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si: tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprimet terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi ta shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

“Furnizim” është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te klientët.

“Furnizues” është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.

“I ankimuar” do të thotë një person, kundër të cilit është paraqitur një ankesë ose ka filluar një hetim nga ERE.

“I licencuar” është një person i pajisur me licencë për aktivitete të energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/ 2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

“Kërkesë” do të thotë një kërkesë me shkrim, e paraqitur në ERE nga një person për një çështje, e cila është objekt i rregullimit nga ERE.

“Klient” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

“Klient fundor” është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

“Kodi i Matjes” është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike.

“Kompensim” është vlera e sasisë monetare ose e energjisë elektrike, e cila i rikthehet klientit në formë dëmshpërblimi, si pasojë e mospërmbushjes së kushteve të kontratës.

“Kontrata e furnizimit” është një kontratë për furnizimin me energji elektrike, por që nuk përfshin derivativët e energjisë elektrike.

“Matës inteligjent” është një pajisje elektronike që regjistron në kohë reale të dhënat e konsumit të energjisë elektrike dhe komunikon këtë informacion, të paktën çdo ditë, tek operatori i sistemit për qëllime të monitorimit dhe të faturimit.

“Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose OSSH” është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

“Operator i Sistemit të Transmetimit ose OST” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

“Operator i rrjetit” është operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes.

“Palë e interesuar” do të thotë një person që merr pjesë në një procedurë të caktuar përpara ERE-s.

“Person” do të thotë çdo person fizik ose juridik, qeveria ose çdo agjenci shtetërore, çdo autoritet lokal ose ente të tjera juridike të njohura nga ligji brenda dhe jashtë vendit, përveç ERE-s.



“Përdoruesit e sistemit” janë personat fizikë ose juridikë të cilët i furnizon ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes.

“Pika e lidhjes” është pika e lidhjes fizike të klientit me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

“Rregullat e tregut” janë rregulla të hollësishme, të cilat përcaktojnë mënyrën e operimit dhe të menaxhimit të tregut, regjistrimin e pjesëmarrësve, përgjegjësinë e balancimit prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, rregullat për llogaritjen e disbalancës për palët përgjegjëse të balancimit, rregullat për përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të balancimit në rast të disbalancimit, si dhe çështje të tjera lidhur me funksionimin e tregut.

“Sistemi i shpërndarjes” është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçese/shkyçese, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe livrimin e saj të klientët, pa përfshirë furnizimin.

“Sistemi i transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçese/shkyçese për livrimin e energjisë elektrike të klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

“Disbalancë” është diferenca midis fluksit të energjisë të përcaktuar në një kontratë dypalëshe dhe fluksit aktual të matur të energjisë për një orë të caktuar.

“Shërbimi i balancimit” është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

“Tarifat dhe çmimet” janë pagesat që duhet të kryhen nga klientët për shërbimet e energjisë elektrike, që sigurohen nga shoqëritë e licencuara nga ERE që ushtrojnë veprimtari të rregulluar në sektorin e energjisë elektrike. Tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike mund të rishikohen nga ERE me propozim të të licencuarve ose me iniciativën e vetë ERE-s, sipas parimeve të parashikuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

“Tarifë e pezullimit ose e ndërprerjes së kontratës” është tarifa e cila paguhet nga klienti

ndaj furnizuesit, në rastin kur kërkon pezullimin ose ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike në pikën e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes, sipas kontratës së furnizimit me energji elektrike. Kjo tarifë nuk është e aplikueshme, në rastin kur klienti ndërpret kontratën e furnizimit me energji elektrike për të ndryshuar furnizuesin.

“Terma dhe kushte” do të thotë dispozita të miratuara nga ERE ndaj një të licencuari, që siguron një ose disa shërbime në sektorin e energjisë elektrike, të cilave do t’u sigurohet shërbimi ose shërbimet e klientëve.

Neni 4

Kushtet paraprake të lidhjes së një kontrate të furnizimit me energji elektrike

4.1 Çdo person fizik apo juridik që ka një pikë lidhjeje të miratuar në rrjetin e sistemit të shpërndarjes ose të transmetimit ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për lidhjen e një kontrate të furnizimit me energji elektrike.

Kërkesa për lidhjen e një kontrate të furnizimit me energji elektrike do të paraqitet me shkrim, pranë zyrave të furnizuesit.

4.2 Furnizuesi duhet të sigurojë në mënyrë lehtësisht të disponueshme dhe pa pagesë për palët e interesuara, informacionin e nevojshëm me shkrim për procedurat e lidhjes së një kontrate të furnizimit me energji elektrike, informacion i cili duhet të jetë i detajuar, transparent dhe të pasqyrohet dukshëm nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit pranë çdo përfaqësie të furnizuesit, përfshirë publikime të këtij informacioni edhe në formën e broshurave apo në formë elektronike në faqen e internetit të furnizuesit dhe të ERE-s.

4.3 Ky informacion duhet të jetë në gjuhën shqipe, në gjuhë të qartë dhe në një format të aksesueshëm për të gjithë të interesuarit.

4.4 Informacioni duhet të përmbajë minimalisht:

1. Dokumentacionin e nevojshëm, të cilin duhet të depozitojë aplikuesi në momentin e paraqitjes së kërkesës për lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, të tilla si: vërtetimi i identitetit dhe i vendndodhjes, si dhe çdo dokumentacion teknik që shërben për realizimin e lidhjes së kontratës;

2. Afatin për trajtimin e kërkesës së aplikuesit për lidhje të një kontrate të furnizimit me energji elektrike;



3. Të drejtat dhe detyrimet e klientit fundor;
4. Të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit;
5. Vendndodhja e zyrave të furnizuesit, ku ofrohet shërbimi i kujdesit ndaj klientit;
6. Procedura e paraqitjes së një ankese dhe afatet e trajtimit të saj;
7. Detyrimin e furnizuesit për mosnxjerrjen e të dhënave personale të klientit.

Neni 5

Lidhja e kontratës

5.1 Aplikuesi që kërkon lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike duhet të informohet mbi aplikimin e tij brenda 15 ditëve kalendarike nga paraqitja e një kërkesë me shkrim, e shoqëruar me dokumentacionin përkatës, pranë çdo përfaqësie të furnizuesit.

5.2 Në rastet kur kërkesa e aplikuesit nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e plotë, furnizuesi, brenda 7 ditësh kalendarike nga dita e paraqitjes së kërkesës, do të njoftojë aplikuesin për mungesat e konstatuara.

5.3 Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e munguar brenda 7 ditësh kalendarike nga momenti i njoftimit. Kërkesa do të refuzohet në rast mosplotësimi të këtij dokumentacioni. Furnizuesi duhet të njoftojë aplikuesin në çdo rast për pranimin ose jo të kërkesës së tij.

Neni 6

Pezullimi dhe përfundimi i kontratës

6.1 Kontrata e furnizimit lidhet për një afat të caktuar nga vetë palët dhe mund të përfundojë para këtij afati, vetëm në rastet e parashikuara si më poshtë:

6.1.1 Me iniciativën e furnizuesit, në rast të shkeljes nga ana e klientit të detyrimeve thelbësore të kontratës, ku do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e klientit, rastet si më poshtë:

a) Nëse klienti nuk paguan detyrimet e energjisë elektrike, duke përfshirë edhe kamatëvonesën, brenda 1 muaji nga ndërprerja e energjisë elektrike, si pasojë e mospagesës së energjisë elektrike;

b) Nëse provohet nga furnizuesi që klienti merr energji elektrike në mënyrë të paligjshme;

c) Nëse klienti, në mënyrë të përsëritur, nuk i krijon akses furnizuesit për më shumë se 3 muaj për leximin e verifikimin e matësve dhe

instalimeve, kur matësi apo sistemi i matjes është brenda kufijve të pronësisë të tij.

6.1.2 Me kërkesë të klientit, pas ekzekutimit të të gjitha detyrimeve monetare dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në kontratën e furnizimit të lidhur mes palëve.

6.1.2.1 Klienti mund të kërkojë pezullimin e kontratës për një periudhë të caktuar, duke paraqitur një kërkesë me shkrim pranë furnizuesit. Klienti do të njoftojë me shkrim furnizuesin 15 ditë kalendarike përpara datës në të cilën kërkon pezullimin dhe do të likuadojë të gjitha detyrimet përkundrejt furnizuesit, jo më vonë se 30 ditë nga kërkesa për pezullimin e kontratës. Klientit do t'i jepet konfirmimi për arkëtimin e tarifës së pezullimit të kontratës (mandati përkatës i arkëtimit). Furnizuesi, pasi të ketë njoftuar me shkrim klientin për pranimin e kërkesës së tij, do të njoftojë operatorin e rrjetit për të bërë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara për këtë qëllim.

6.1.2.2 Klienti është përgjegjës për ekzekutimin e detyrimeve që lidhen me konsumin e energjisë elektrike deri në momentin e pezullimit të kontratës. Në çdo rast, klienti nuk është përgjegjës për asnjë detyrim ndaj furnizuesit pas kalimit të afatit prej 30 ditësh kalendarike nga kërkesa për pezullimin e kontratës, të parashikuar në nenin 6.1.2.1.

6.2 Pas pezullimit të kontratës së furnizimit me energji elektrike, klienti, në çdo rast, ka të drejtë ta riaktivizojë atë, duke paraqitur një kërkesë me shkrim pranë çdo përfaqësie të furnizuesit për riaktivizimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike.

6.3 Pas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga klienti, furnizuesi do të bëjë të mundur riaktivizimin e kontratës së furnizimit brenda 48 orëve dhe do të njoftojë operatorin e rrjetit për të kryer rilidhjen e energjisë elektrike.

6.4 Sipas të njëjtave përcaktime të pikës 6.1.2.1, klienti mund të kërkojë të ndërpresë kontratën e furnizimit me energji elektrike. Në këtë rast, ai do të njoftojë me shkrim furnizuesin 15 ditë kalendarike përpara dhe do të likuadojë të gjitha detyrimet përkundrejt furnizuesit, jo më vonë se 30 ditë nga ndërprerja e kontratës. Klientit do t'i jepet konfirmimi për arkëtimin e tarifës së ndërprerjes së kontratës (mandati përkatës i arkëtimit). Në rast të ndërprerjes së kontratës së furnizimit me energji



elektrike, me qëllim ndryshimin e furnizuesit, tarifa e ndërprerjes së kontratës nuk do të jetë e aplikueshme nga ana e furnizuesit.

6.5 Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, furnizuesi do të kërkojë nga operatori i rrjetit të ndërpresë menjëherë furnizimin e energjisë elektrike në pikën e lidhjes. Me ndërprerjen e furnizimit, furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vulosë pikën e lidhjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.6 Klienti është përgjegjës për ekzekutimin e detyrimeve që lidhen me konsumin e energjisë elektrike deri në momentin e ndërprerjes së kontratës. Në çdo rast, klienti nuk është përgjegjës për asnjë detyrim të lindur ndaj furnizuesit, pas kalimit të afatit të parashikuar në nenin 6.4.

6.7 Furnizuesi nuk do të kryejë ndërprerjen e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, nëse më parë nuk ka informuar klientin me shkrim, për ndërprerjen e mundshme të shërbimit. Në çdo rast, furnizuesi duhet t'i ofrojë klientit mundësi për mënyra të ndryshme të shlyerjes së detyrimeve ndaj tij.

6.8 Në çdo rast të ndërprerjes së energjisë elektrike apo të kontratës, furnizuesi do të lëshojë faturën finale jo më vonë se 20 ditë nga ndërprerja e shërbimit.

PJESA E TRETË TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 7

Detyrimet e furnizuesit

7.1 Furnizuesi ka detyrimin të furnizojë klientët me energji elektrike, në përputhje me kontratën e nënshkruar, në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase.

7.2 Furnizuesi ka detyrimin të informojë klientët e tij, për:

a) Të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të energjisë elektrike;

b) Konsumin dhe kostot aktuale të energjisë elektrike, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të energjisë nga ana e klientëve;

c) Mënyrat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve.

Sistemet e parapagimit, nëse do të aplikohen, duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm;

ç) Mundësinë e përdorimit të procedurave të thjeshta për ndjekjen e ankesave të tyre;

d) Ndryshimin e kushteve të kontratës të paktën 15 ditë përpara zbatimit të tyre, duke përfshirë informacionin në lidhje me të drejtën e klientëve për të zgjedhur në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit, me dhënien e njoftimit;

e) Të dhënat e konsumit të tij, duke i mundësuar çdo klienti akses ndaj të dhënave të matjes, në bazë të një marrëveshjeje të qartë dhe pa pagesë;

f) Të dhëna për çdo burim energjie të siguruar nga furnizuesi gjatë vitit të mëparshëm;

g) Elementet përbërëse të çmimit dhe kostot përkatëse;

h) Të dhënat për ndikimin në mjedis të gazit karbonik dhe mbeturinave radioaktive të emetuara gjatë prodhimit të energjisë elektrike, të siguruar nga furnizuesi në vitin e mëparshëm

7.3 Furnizuesi duhet t'i ofrojë klientit informacion të mjaftueshëm, ku përshkruhen qartësisht shërbimet e ofruara, ofertat përkatëse, rrethanat e ndërprerjes së shërbimit të furnizimit, si dhe pagesave të tjera të lidhura me shërbimin e furnizimit apo të ndërprerjes së tij. Të gjithë klientët do të kenë të drejtën për të përfituar kushte të njëjta të furnizimit nga furnizuesi i zgjedhur prej tyre.

Neni 8

Të drejtat e furnizuesit

8.1 Furnizuesi ka të drejtë të kërkojë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga operatori i rrjetit, pasi e ka njoftuar klientin me shkrim, sipas përcaktimeve të pikës 6.7, në rastet kur klienti nuk përmbush detyrimet kontraktore.

8.2 Në çdo rast, furnizuesi do të bëjë rilidhjen e energjisë elektrike, kur klienti ka përmbushur detyrimet, të cilat shkaktuan ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike.

Neni 9

Të drejtat e klientit fundor

9.1 Të gjithë klientët kanë të drejtë të zgjedhin furnizuesin e tyre të energjisë elektrike, vendës ose të huaj, me çmime të parregulluara sipas një marrëveshjeje furnizimi, e cila është në përputhje me rregullat e tregut dhe kushtet e përgjithshme



për furnizimin me energji elektrike të miratuara nga ERE.

9.2 Klienti fundor ka të drejtë:

a) Të furnizohet me energji elektrike në përputhje me kushtet e vendosura në kontratë;

b) Të paraqesë ankesë pranë ERE-s nëse nuk furnizohet sipas kushteve të vendosura në kontratë;

c) Të përfitojë nga furnizuesi një trajtim jodiskriminues;

ç) Të marrë të gjitha informacionet e nevojshme nga furnizuesit, në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje;

d) Të marrë informacion të plotë për çmimet, tarifën, termat dhe kushtet standardë, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike;

dh) Të përdorë mekanizma të ndryshëm të pagesës dhe të mbrohet prej metodave të padrejta të faturimit;

e) Të ndryshojë furnizuesin pa asnjë kosto shtesë, në përputhje me “Rregullat për ndryshimin e furnizuesit”, të miratuara nga ERE;

ë) Të përfitojë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tij, të cilat kur është e mundur, parashikojnë një sistem rimbursimi dhe/ose kompensimi;

f) Të informohet për të drejtën e tij për sa i përket shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike;

g) Të informohet për konsumin e tij dhe kostot respektive të energjisë elektrike, në varësi të pajisjeve matëse, me të cilat është i pajisur klienti. Ky shërbim ofrohet pa kosto shtesë për klientin.

gj) Të marrë një informacion për konsumin dhe gjendjen financiare të mbylljes, pas çdo ndryshimi të furnizuesit të energjisë elektrike, jo më vonë se 20 ditë nga ndryshimi i tij.

9.3 Në çdo rrethanë, kushtet e përcaktuara në kontratën e lidhur me furnizuesin nuk kufizojnë të drejtën e klientit për të ndryshuar furnizuesin për shkak të një kontrate afatgjatë. Në mënyrë të veçantë, në kushtet e ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike, klientët kanë të drejtë të ndërpresin kontratën, pa kosto shtesë. Ndryshimi i furnizuesit bëhet me kërkesë të klientit fundor dhe pa kosto shtesë për të. Furnizuesi aktual është i detyruar të furnizojë klientin fundor, deri në momentin e përfundimit të procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

9.4. Klientët jofamiljarë, të lidhur në rrjetin e tensionit të mesëm dhe rrjetin e tensionit të lartë, kanë të drejtë të kontraktjnë në të njëjtën kohë disa furnizues.

Neni 10

Detyrimet e klientit fundor

10.1 Klienti fundor ka detyrimin:

1. Të paguajë për energjinë elektrike, në përputhje me kushtet e kontratës;

2. Të mundësojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ose Operatorit të Sistemit të Transmetimit instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e pajisjeve për matjen e konsumit të energjisë elektrike;

3. Të respektojë kushtet e kontratës së furnizimit me energji elektrike.

4. Klientët fundorë janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara, sipas përcaktimeve të bëra lidhur me balancimin e energjisë elektrike në “Modelin e tregut të energjisë elektrike”, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, “Rregullat e tregut të energjisë elektrike” dhe “Rregullat e balancimit” të miratuara nga ERE.

5. ERE vendos përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat, për kategori të caktuara të klientëve fundorë, të cilët furnizohen mbi bazën e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik.

PJESA E KATËRT

KUSHTET E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

Neni 11

Çmimi i energjisë elektrike

11.1 Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike për klientët që nuk furnizohen nga shërbimi universal përcaktohet në marrëveshje mes klientit dhe furnizuesit të zgjedhur prej tij. Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditur klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike.

11.2 Ndryshimet e çmimit të energjisë elektrike bëhen me marrëveshje të përbashkët. Furnizuesi, në çdo rast njofton klientin me shkrim, për ndryshimin e çmimit, jo më vonë se 15 ditë kalendarike përpara aplikimit të çmimit të ri.



11.3 Njoftimi duhet t'i referohet specifkisht ndryshimit të çmimit dhe jo informacioneve të tjera që lidhen me shërbimin e furnizimit.

Neni 12

Leximi i matësit dhe faturimi i energjisë elektrike

12.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të klientit për një periudhë kohore, siç është rënë dakord në kontratën e nënshkruar nga palët dhe do t'i dërgojë klientit në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.

12.1.1 Çdo faturë e energjisë elektrike duhet të përmbajë minimalisht:

- Të dhënat teknike mbi pikën e lidhjes;
- Të dhënat identifikuese të klientit;
- Datën e leximit;
- Periudhën e faturuar;
- Leximin e matësit dhe konsumin përkatës për periudhën e faturuar;
- Çmimin për njësi sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij;
- Shumën në lekë që i korrespondon periudhës së faturimit;
- Shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi;
- Datën limit të pagimit të faturës;
- Kamatëvonesën e aplikuar për çdo ditë vonese;
- Penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar;
- Vlerën e detajuar të gjendjes debitore të klientit;
- Vlerën e detajuar të gjendjes kreditore të klientit, në rast të funksionimit të skemave të parapagimit;
- Informacione të nevojshme për kujdesin ndaj klientit (përfshirë *website*-in e kompanisë, numrat e telefonit, *e-mail* për ankesat, për defektet, si dhe të ERE-s).

12.2 Furnizuesi do të sigurojë pa pagesë aksesin *online* të faturës së energjisë elektrike për çdo klient, duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe të faturimit.

12.3 Energjia elektrike e hedhur në rrjet ose e faturuar te klientët fundorë matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet e Kodit të Rrjeteve dhe Kodit të Matjes, si dhe në legjislacionin në fuqi për metrologjinë. Klientët

kanë të drejtë të instalojnë njësi matjeje shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

Neni 13

Faturimi i energjisë elektrike gjatë mosfunksionimit të aparatit matës

1. Faturimi i energjisë elektrike për ditët që klientit i është hequr aparati matës, për shkak të kontrollit periodik, me kërkesë të klientit apo furnizuesit ose në rast të mosfunksionimit të aparatit matës, do të bëhet bazuar në vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

2. Nëse furnizuesi nuk respekton afatin e përcaktuar në pikën 1 për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati do të jetë zero.

Neni 14

Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

1. Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën periodike të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të afatit të përcaktuar në kontratën mes palëve.

2. Klienti mund të zgjedhë mënyrën e pagesës së faturës së energjisë elektrike me një nga mundësitë që furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet pagesës së drejtpërdrejtë në zyrat e furnizuesit, bankave, zyra postare apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare).

3. Të gjitha pagesat sipas këtyre kushteve duhet të përmbajnë të dhënat siç janë numri i transfertës bankare, numri i llogarisë dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në faturën e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë numrin e kontratës, numrin e faturës dhe emrin e klientit.

4. Sipas marrëveshjes me klientin faturat mund t'i dërgohen:

- klientit në adresën e përcaktuar në kontratën e lidhur mes palëve;
- në adresë të një personi të tretë, i cili është përcaktuar si pagues nga klienti, sipas pëlqimit të tij;
- në çdo formë tjetër komunikimi e dakordësuar midis klientit dhe furnizuesit.

5. Në të gjitha rastet, klienti është përgjegjës për pagesën e plotë të të gjitha faturave të dërguara sipas pikës 4 të këtij neni. Në rast se klienti ndërron



vendbanim pa njoftuar, ai është përgjegjës për mospagesat e faturave të energjisë.

6. Palët bien dakord që në rast të pagesave të paidentifikuara të bëra nga klienti apo mbipagesave të tjera të faturës/ave, furnizuesi ka të drejtë të balancojë detyrimet aktuale apo të mbartura të klientit dhe shuma përkatëse të konsiderohet si parapagesë e detyrimeve të muajit pasardhës të klientit.

Neni 15

Kamatëvonesa për pagesë të vonuar

Pas kalimit të afatit të pagesës të caktuar në kontratën mes palëve, nëse nuk përcaktohet ndryshe në kontratë, klienti është i detyruar të paguajë një kamatëvonesë, e cila në çdo rast nuk mund të jetë më e lartë se vlera e vetë faturës.

Neni 16

Pasojat e mospagesës

Në mungesë të pagesës nga klienti të faturës brenda afatit të përcaktuar në kontratë, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara, në adresën e përcaktuar në kontratë, si dhe sipas përcaktimeve nenit 14, pika 4.

Neni 17

Ankimi për faturimin dhe kushtet e furnizimit të energjisë elektrike

1. Klienti fundor ka të drejtë të paraqesë një ankim pranë furnizuesit, për çdo veprim apo mosveprim të furnizuesit, që lidhet me të drejtat e detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë, me shkrim, me gojë, me telefon (*call center*) ose në rrugë elektronike.

2. Furnizuesi do të trajtojë çdo ankesë në përputhje me “Rregulloren e trajtimit të ankesave”, të miratuar nga ERE. Kjo rregullore bëhet publike në zyrat ku bëhen pagesat e energjisë elektrike apo në zyrat e kujdesit ndaj klientit dhe në faqet elektronike të furnizuesit apo të ERE-s.

3. Në rast se furnizuesi nuk i kthen përgjigje për ankesën klientit brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren e trajtimit të ankesave”, të miratuar nga ERE apo nëse klienti nuk është dakord me përgjigjen e dhënë prej furnizuesit, atëherë ai ka të drejtë të paraqesë ankesën në ERE, sipas

procedurave të përcaktuara në “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror” të ERE-s.

4. Klienti mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga furnizuesi, si në rast kur dyshon në saktësinë e faturimit, gabime të tjera të konstatuara në faturë apo pasaktësi në sistemin e matjes.

5. Në rast se pas verifikimeve të furnizuesit rezulton se konsumatori është faturuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e kontratës, atëherë furnizuesi:

i) anulon faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrigtuar;

ii) në rast se është kryer pagesa realizon kompensimin përkatës në faturën pasardhëse të klientit, duke pasqyruar zë për zë detajet e kompensimit në faturën pasardhëse të energjisë elektrike;

6. Në rast të moskompensimit brenda afatit të përcaktuar me sipër në kontratën e lidhur mes palëve, furnizuesi duhet të kompensojë klientin, për çdo ditë vonese, mbi vlerën e diferencës për t'u korrigjuar, e zbritshme në faturën pasardhëse të energjisë elektrike.

7. Mekanizmi i llogaritjes së kompensimit nga ana e furnizuesit për klientin do të specifikohet sipas përcaktimeve në kontratën e dakordësuar mes palëve.

Neni 18

Instalimi dhe pronësia

1. Furnizuesi, me shpenzimet e veta, instalon te klienti, në përputhje me kërkesat e legjislacionit, sistemin e matjes së energjisë elektrike dhe e lidh atë me rrjetin e shpërndarjes me nënshkrimin e kësaj kontrate.

2. Matësi dhe/ose sistemi matës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për metrologjinë dhe pas instalimit duhet të bashkëvulosen nga operatori i sistemit dhe DPM-ja ose nga personi juridik i autorizuar prej saj.

3. Klasa e saktësisë së matësve të energjisë elektrike përcaktohet në Kodin e Matjes, të miratuar nga ERE.

4. Në veprimtarinë e matjes së energjisë elektrike mund të implementohen sisteme matëse inteligjente te klientët fundorë.



5. Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matjeje shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

6. Klienti është përgjegjës për cilësinë, kushtet teknike dhe ato të sigurimit teknik që lidhen me kryerjen e instalimeve elektrike brenda objektit apo banesës së tij.

7. Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të energjisë elektrike të vendosur nga furnizuesi brenda kufijve të pronës së klientit.

Neni 19

Kontrolli i sistemit matës

1. Aparatet matëse verifikohen përpara vënies në përdorim, nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike.

2. Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo personit juridik të autorizuar. Periodiciteti i verifikimit të matësve të instaluar te klienti përcaktohet në Kodin e Matjes. Në çdo rast duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i operatorit të sistemit.

3. Kontrolli i sistemit të matjes bëhet në prezencë të klientit fundor, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike.

4. Kur klienti dyshon në saktësinë e aparatit matës paraqet një kërkesë me shkrim pranë operatorit të rrjetit, si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës për verifikimin e aparatit matës. Procedura për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuarit miratohen me vendim të ERE-s. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur ankesën.

5. Në rast të ndërhyrjeve në sistemin e matjes nga Klienti, me qëllim të manipulimit apo mosregjistrimit të saktë të energjisë së konsumuar, ndaj tij do të procedohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

6. Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti, bëhen përlogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës dhe mënyra e

rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.

7. Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti, nga ana e operatorit të rrjetit merren masa për zëvendësimin e sistemit të matjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 20

Furnizimi dhe karakteristikat e energjisë elektrike

20.1 Furnizuesi do të sigurojë furnizimin të pandërprerë dhe me cilësi të energjisë elektrike. Furnizuesi mund të ndërpresë furnizimin e energjisë elektrike në rastet e mëposhtme:

a) Për shkaqe të forcës madhore - ndërprerje të shkaktuara nga ngjarje të jashtëzakonshme natyrore dhe përcaktimeve të tjera sipas ligjit.

b) Ndërprerje për shkak të urdhrave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit;

c) Për efekt të garantimit të sigurisë së jetës, shëndetit dhe pasurisë së personave;

d) Ndërprerje të planifikuara për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, remonteve të programuara të linjave dhe të pajisjeve të sistemit të shpërndarjes, duke njoftuar paraprakisht sipas afateve të përcaktuara në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”;

e) Ndërprerje të paplanifikuara (të shkurtra apo të gjata), për shkak të defekteve dhe dëmtimeve të linjave dhe pajisjeve të sistemit të shpërndarjes.

20.2 Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për ndërprerjet e parashikuara në gerrat “a”, “b”, “c” të këtij neni. Për ndërprerjet e parashikuara në gerrat “d” dhe “e” të pikës 20.1, furnizuesi është i detyruar të respektojë normat dhe procedurat e përcaktuara në rregulloret: “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe “Për kriteret standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, të miratuara nga ERE.

20.3 Në rast të mosrespektimit të normave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloret: “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe “Për kriteret standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e



transmetimit të energjisë elektrike”, të miratuara nga ERE, furnizuesi është përgjegjës për kompensimin e klientit, sipas kërkesës së këtij të fundit, në përputhje me procedurën dhe masën e kompensimit të përcaktuar në rregulloren e mësipërme.

20.4 Në asnjë rast, përfitimi i kompensimit nga ana e klientit, kur plotësohen kushtet e nenit 19.3, nuk e përjashton të drejtën e tij për të kërkuar në rrugë gjyqësore dëmin efektiv të shkaktuar.

PJESA E PESTË DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s dhe më pas gjykatës civile për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 22

Amendimi i rregullores

Kjo rregullore është objekt rishikimi, me vendim të bordit të ERE-s, sipas “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga bordi i ERE-s.

VENDIM

Nr. 204, datë 18.12.2017

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RTS SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, ndryshuar me

vendimin nr. 718, datë 12.10.2016; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1 germa “a”; të nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë RTS sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 4.4.4 (dokumentacioni tekniko-ekonomik, gjerat), do të njoftohet subjekti që ta plotësojë atë brenda afateve që përcakton rregullorja “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë RTS sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me fuqi të instaluar 2 mw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 205, datë 18.12.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI
ASHTA” SHPK, NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., me shkresën nr. 714 prot., datë 2.11.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., me shkresën nr. 714/2 prot., datë 12.12.2017 ka paraqitur dokumentacionin shtesë në mbështetje të kërkesës për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germa “a”, “b”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 9, pika 2 dhe pika 3, germa “a”, do të njoftohet subjekti, që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 206, datë 18.12.2017****PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN RREGULLORES “MBI
KUSHTET E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME GAZ
NATYROR PËR KLIENTËT FUNDORË”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 16, pika 10, të ligjit nr. 102 /2015, “Për sektorin e gazit natyror”; si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e rregullores “Mbi kushtet e përgjithshme, në shërbimin e furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Neni 16, i ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, në pikën 10 të tij, përcakton si përgjegjësi të ERE-s, miratimin e kushteve të përgjithshme të furnizimit, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e rregullores “Mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë të gjitha palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 207, datë 18.12.2017****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR CILËSINË E FURNIZIMIT DHE
PERFORMANCËN E SIGURISË SË
RRJETIT NË SISTEMIN E
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1; nenit 16; nenit 19, germa “h” dhe “j”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, pasi shqyrtoi relacionin e “Rregullores së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

1. Me vendimin nr. 5, datë 27.1.2016, bordi i ERE-s vendosi: “Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit”.

2. Me shkresën nr. 132 prot., datë 4.2.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draftin e rregullores “Për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike” për opinion.

3. Me shkresën me nr. 716 prot. të ERE-s, datë 7.10.2016, kanë ardhur komente nga USAID-i mbi draftin e rregullores “Për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, duke propozuar vendosjen e një periudhe tranzitore lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve, në kuadër të ristrukturimit të sektorit të energjisë elektrike dhe implementimit të modelit të ri të tregut.

4. Në shkresën e saj me nr. 775/1 prot. i ERE-s, datë 18.11.2016, OST-ja ka paraqitur komentet e saj, lidhur me draftin e rregullores “Për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, në të cilat janë janë shqyrtuar dhe reflektuar ndryshimet e nevojshme.



5. Me shkresën nr. 653 prot., datë 4.10.2017, i është dërguar shoqërisë OST sh.a., edhe një herë drafti i rregullores “Për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, me të gjitha ndryshimet e reflektuara, si pasojë e propozimeve të ardhura.

6. Në përgjigje të shkresës nr. 653 prot., datë 4.10.2017, shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 5315/1 prot., datë 10.10.2017, ka paraqitur disa komente të tjera për draftin, të cilat janë shqyrtuar dhe reflektuar ndryshimet e nevojshme.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. dhe gjithë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE **PËR CILËSINË E FURNIZIMIT DHE** **PERFORMANCËN E SIGURISË SË RRJETIT** **NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË** **ENERGJISË ELEKTRIKE**

PJESA I **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1 **Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 7 dhe nenit 19, germa “h” dhe “j”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, neni 40; Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

Neni 2 **Objekti**

1. Kjo rregullore specifikon treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe performancën në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. OST-ja ka detyrimin e shërbimit publik që të përmbushë standardet e cilësisë së furnizimit të specifikuar nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit dhe kjo rregullore.

Neni 3 **Përgjegjësitë dhe autoriteti i ERE-s**

1. Bazuar në nenin 19, germa “h” dhe “j”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka përgjegjësitë dhe autoritetin e mëposhtëm në lidhje me çështjet e cilësisë së furnizimit me energji elektrike:

a) Të publikojë kushtet për cilësinë e furnizimit të ofruar nga operatorët e sistemit;

b) Të nxisë përmirësimin e cilësisë së shërbimit në sektorin e energjisë elektrike.

2. Bazuar në nenin 25, pika 2, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE duhet të përfshijë te raporti vjetor, i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë, brenda datës 31 mars të çdo viti, informacionin mbi të dhënat për cilësinë e furnizimit. Si pasojë, të licencuarit duhet të paraqesin informacion për cilësinë e furnizimit në ERE, sipas nenit 6 dhe 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 4 **Përkufizimet për treguesit e performancës**

Treguesit e performancës të përdorur në këtë rregullore janë si më poshtë:

“Enti Rregullator i Energjisë ose ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

“Operator i Sistemit të Transmetimit ose OST” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të

arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

“Furnizues” është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike.

“Klient” është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

“Klient fundor” është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

“Klientë jofamiljarë” janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.

“Detyrimi i shërbimit publik” është detyrimi që vendoset ndaj një të licencuari për kryerjen e një shërbimi publik, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, eficiencën e energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.

“Koha mesatare e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike (AIT)” nënkupton treguesin e matjes së kohës së ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike në sistem (orë në vit).

$$AIT = \frac{8760 \times \sum_i E_i}{E_t}$$

Ku: E_t është energjia totale e furnizuar nga sistemi i transmetimit për konsumatorët (në mwh) dhe E_i energjia e pafurnizuar (në mwh) për çdo rast (incident)

“Energjia e pafurnizuar (ENS)” nënkupton sasinë totale të energjisë (në mwh) që duhet t’u ishte furnizuar konsumatorëve, të cilëve iu është ndërprerë energjia elektrike, nëse nuk do të kishte pasur ndërprerje. Ajo llogaritet si shumë e energjisë së pafurnizuar për çdo rast ndërprerjeje.

$$ENS = \sum_i E_i$$

Ku: E_i = është energjia e pafurnizuar për çdo rast

“Cilësia e frekuencës (FQ)” nënkupton një tregues të matjes së devijimit të frekuencës së sistemit mbi ose nën vlerën nominale prej 50 Hz, duke pasur në konsideratë se:

1. Frekuenca nominale në sistemin elektroenergjetik të vendit, i cili operon në mënyrë sinkrone me rrjetin evropian të transmetimit ENTSO-E është 50 Hz.

2. OST-ja do të sigurojë që nivelet e lejuara të frekuencës në sistemin elektroenergjetik do të jenë në përputhje me kërkesat për cilësinë e frekuencës, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe standardeve të ENTSO-E.

3. OST-ja do të sigurojë rezerva rregullimi për mbajtjen e frekuencës së sistemit, në përputhje me gjendjen e sistemit, duke administruar dhe monitoruar frekuencën në përputhje me procedurat e menaxhimit të frekuencës dhe në çdo rast, duke zbatuar planin e mbrojtjes dhe rivendosjes së sistemit elektroenergjetik, siç është përshkruar në Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

“Periudha e njoftimit për ndërprerje të planifikuar në sistemin e transmetimit” nënkupton numrin e orëve dhe ditëve në avancë të dhënies së njoftimit për konsumatorët e lidhur direkt në sistemin e transmetimit dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes (OSHEE), lidhur me ndërprerjet e planifikuara.

“Zgjidhja e ankesave për cilësinë e tensionit” nënkupton përqindjen e ankesave për devijimet e tensionit jashtë kufijve të specifikuar në Kodin e Rrjetit që janë zgjidhur brenda afatit kohor të përcaktuar në “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Ky tregues llogaritet në mënyrë të veçantë për zonat urbane dhe ato rurale.

“Koha e nevojshme për kërkesat për lidhjet e reja” nënkupton kohën që i nevojitet OST-së për të dhënë një përgjigje me shkrim për kërkesën për lidhje të re. Kjo kohë mund të llogaritet në mënyrë të veçantë sipas niveleve e ndryshme të tensionit të pikës së lidhjes. Llogaritja e kohës do të marrë në konsideratë afatet përkatëse për trajtimin e kërkesave për lidhje, bazuar në “Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”.

“Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve (SAIDI)”, zakonisht i referohet kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve për klientët, të cilët kanë ndërprerje gjatë një periudhe kohore (vit, tremujor, gjashtëmujor). Ai llogaritet si raport i shumës të të gjitha kohëzgjatjeve të ndërprerjeve të



konsumatorëve të ndërprerë me numrin total të konsumatorëve, sipas formulës së mëposhtme:

$$SAIDI = \frac{\sum_{i=1}^K D_i \times N_i}{N_T}$$

Ku: N_i = numri i konsumatorëve të përfshirë në ndërprerjen “i”

N_T = është numri total i konsumatorëve të furnizuar gjatë atij viti

D_i = kohëzgjatja e ndërprerjes “P”

K = numri total i ndërprerjeve

“Cilësia e tensionit (VQ)” nënkupton vlerësim i devijimit të tensionit mbi ose nën vlerën nominale të pritshme për tensionin e rrjetit, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit. Ajo llogaritet në mënyrë të veçantë për çdo tension nominal për zonat urbane dhe ato rurale.

Çdo përkufizim ose term tjetër i përdorur në këtë rregullore, ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

PJESA II

TREGUESIT E CILËSISË DHE PERFORMANCËS

Neni 5

Treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit

1. Më poshtë jepen treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit, të cilët duhet të llogariten nga OST-ja dhe të raportohen në ERE:

- Koha mesatare e ndërprerjes (AIT);
- Energji e pafurnizuar (ENS);
- Cilësia e frekuencës (FQ);
- Periodha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e transmetimit;
- Koha e nevojshme për t’iu përgjigjur kërkesave për lidhje të reja;
- Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve (SAIDI);
- Cilësia e tensionit (VQ);
- Përqindja e ankesave për cilësinë e tensionit.

Neni 6

Raportimi i treguesve të matjes së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit

1. OST-ja ka përgjegjësinë të grumbullojë të gjitha të dhënat e nevojshme për të llogaritur treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje dhe të mbajë informacionin për rishikim periodik nga ERE. Të dhënat duhet të llogariten mbi baza tremujore dhe në mënyrë progresive përgjatë vitit kalendarik dhe treguesit e matjes së cilësisë së shërbimit duhet t’i raportohen ERE-s, jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tremujorit. Për shembull, brenda datës 30 janar të çdo viti duhet të raportohen të dhënat vjetore në progresiv për vitin paraardhës (nga muaji janar në dhjetor).

2. Në funksion të krijimit të një baze të dhënash për vlerësimin e treguesve të matjes së cilësisë së furnizimit, OST-ja duhet të ofrojë të dhëna për treguesit e matjes së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, për vitet kalendarike 2014 e në vijim, brenda 90 ditësh kalendarike nga hyrja në fuqi e rregullores. Në rast se të dhënat për një ose më shumë tregues të matjes së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit, të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje, nuk janë të mundura të vihen në dispozicion, OST-ja duhet të informojë ERE-n për këtë fakt.

3. Raportimi tremujor do të kërkohet për çdo tremujor nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Neni 7

Kriteret standarde të performancës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit

1. Në tabelën 1 të kësaj rregulloreje ndodhen kriteret standarde të performancës për OST-në që kanë lidhje me treguesit e matjes së cilësisë së furnizimit të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje. Nivelet e pritshme të performancës do të vihen në zbatim brenda datës 31 dhjetor 2018, duke u rivlerësuar në funksion të performancës së ushtruar gjatë kësaj periudhe tranzitore dhe gjendjes së sektorit të energjisë elektrike.

2. OST-ja nuk do të jetë subjekt i kërkesës për kompensim nga ana e klientëve fundorë të lidhur në rrjetin e transmetimit, lidhur me



mospërbushjen e treguesve të matjes së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit, përpara datës 31 dhjetor 2018.

3. OST-ja do të propozojë në ERE nivelin e lejuar të treguesve të matjes së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit, jo më vonë se data 31 shtator 2018.

4. Në vitin 2019, ERE do të rishqyrtojë performancën e ushtruar gjatë viteve 2017–2018, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit.

Neni 8

Monitorimi dhe mbikëqyrja

1. ERE, duke vepruar sipas kompetencave të saj, do të sigurojë monitorimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje.

2. Të licencuarit, klientët dhe të gjithë personat përgjegjës, të cilët me anë të veprimeve apo mosveprimeve të tyre, do të cenojnë kriteret standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit, të miratuara në këtë rregullore, do të jenë përgjegjës sipas përcaktimeve të ligjit për sektorin e energjisë elektrike.

Neni 9

Kompensimi i klientëve fundorë

1. Duke filluar nga data 1 janar 2019, kompensimi i klientëve fundorë të lidhur në rrjetin e transmetimit, në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit, në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, do të bëhet bazuar në përcaktimet e Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe Marrëveshjes së Shërbimit të Transmetimit.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit përjashtohet nga detyrimi për kompensim të klientëve fundorë, në rastet e rënies së sistemit për shkak të cilat nuk vijnë nga OST-ja, siç mund të jenë incidentet e mëdha, të përcaktuara sipas shkallës së klasifikimit të incidentit, në përputhje me udhëzuesin e operimit të ENTSO-E.

Neni 10

Mospërbushja e detyrimeve

1. Kur një palë është e paaftë për të përbushur detyrimet sipas këtyre rregullave dhe parametrave, për shkak të një ngjarjeje të shkaktuar nga forca madhore, duhet të njoftojë ERE-n dhe të gjitha palët e ndikuara, ku detajon arsyet për paaftësinë e përbushjes së detyrimeve dhe kohëzgjatjen e pritshme.

2. Gjatë periudhës së forcës madhore detyrimet e palëve do të pezullohen.

3. Nëse ndonjë palë vlerëson se deklarimi i forcës madhore është i paarsyeshëm, mund ta referojë çështjen në ERE për rishikim dhe vendimi i ERE-s do të jetë final.

4. Në rast se ERE përcakton se arsyet për mospërbushje të detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, nuk ishin për shkak të forcës madhore, atëherë detyrimet e palës pretenduese nuk do të konsiderohen si të pezulluara.

PJESA III

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që do të lindin si rezultat i moszbatimit të këtyre rregullave dhe parametrave, do të trajtohen nga ERE në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

Neni 12

Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave

Kjo rregullore është objekt rishikimi ose ndryshimi me vendim të bordit të ERE-s.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.



TABELA 1
TREGUESIT E KRITEREVE STANDARDE
TË PERFORMANCËS PËR
OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

Treguesi	Niveli i pritshëm i performancës
a) Koha mesatare e ndërprerjes (AIT)	
b) Energjia e pafurnizuar (ENS)	
c) Cilësia e frekuencës (FQ)	
d) Periudha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e transmetimit	
e) Koha e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave për lidhjet e reja	
f) Indeksi i kohëzgjatjes së ndërprerjeve mesatare (SAIDI)	
g) Cilësia e tensionit (VQ)	
h) Përqindja e ankesave për cilësinë e tensionit	

VENDIM

Nr. 208, datë 18.12.2017

MBI PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2017

Në mbështetje të neneve 16; 17, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenin 4, pika 69 dhe nenit 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 6 të “Rregullores për përcaktimin dhe miratimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2017, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, dhe konsideroi të drejtë llogaritjen e pagesave të rregullimit mbështetur mbi të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar,

konstatoi se:

1. Rezultojnë 285 të licencuar nga ERE, të cilët janë subjekt i pagesave rregullatore sipas klasifikimit në vijim:

- Licenca prodhimi - 122
- Licenca për ndërtim, instalim dhe prodhim - 10
- Licenca për transmetim të energjisë elektrike/gazit natyror - 2

- Licenca për shpërndarje të energjisë elektrike/gazit natyror - 2

- Licenca për furnizim të energjisë elektrike/gazit natyror - 39

- Licenca për tregtim të energjisë elektrike/gazit natyror - 110

2. Të ardhura të rregulluara për efekt të llogaritjes së tarifave të rregullimit do të konsiderohen:

a) Për kompanitë e prodhimit të energjisë elektrike - të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë elektrike të prodhuar.

b) Për kompanitë e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike/gazit natyror - të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë apo gazit natyror.

c) Për kompanitë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike/gazit natyror - të ardhurat (vlëra e shtuar) të realizuara nga shitblerja e energjisë elektrike/gazit natyror.

3. Vazhdon të ketë problematika në dërgimin e pasqyrave financiare dhe informacioneve të tjera, nga subjektet e licencuara.

4. Subjektet e licencuara për aktivitetet e prodhimit dhe të tregtimit të energjisë, në pasqyrat financiare të konsoliduara, nuk japin informacion për aktivitetin tregtar dhe për shumicën e të licencuarve rezultojnë të jetë zero.

5. Me gjithë problematikat e përmendura më sipër, informacioni i grumbulluar nga kompanitë, përgjithësisht konsiderohet i vlefshëm për përllogaritje, duke ruajtur të drejtën për korrigjim/rishikim.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesat e rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe sektorin e gazit natyror, për vitin 2017, sipas tabelës bashkëngjitur.

2. Drejtoria e Administrim-Financës, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë të njoftojë të licencuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

3. Nëse i licencuari nuk bën pagesën brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ERE ka të drejtë të aplikojë masat administrative, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenin 106, të ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Nr.	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2016 (lekë)	Pagesa Rregullatore 2017 (lekë)
1	"Albanian Green Energy" sh.p.k	350,129	176,906
2	"Balkan Green Energy" sh.p.k	543,541	286,052
3	"EMIHEL 2003" sh.p.k	51,943	21,086
4	"Amal" sh.p.k	35,648	14,507
5	"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	113,854	48,030
6	"Wonder power" sh.a.	95,227	48,947
7	"Heci Tervolit" sh.p.k	391,742	206,036
8	"HIDROALBANIA Energji" sh.p.k	198,543	118,589
9	"HEC Bishnica 1,2" sh.p.k	135,102	66,139
10	"Dishnica Energy" sh.p.k.	21,775	3,672
11	"Elektro Lubonje" sh.p.k.	18,432	2,318
12	"Selca Energji" sh.p.k.	37,309	28,621
13	"Projeksion Energji" sh.a.	16,298	4,541
14	"Sarolli" sh.p.k.	29,263	9,364
15	"Juana" sh.p.k	25,353	6,727
16	"WTS Energji" sh.p.k	22,933	4,740
17	"Marjakaj" sh.p.k	27,852	8,112
18	"Maksi Elektrik" sh.p.k	22,106	5,969
19	"Favina 1" sh.p.k	134,138	74,060
20	"EN-KU" sh.p.k	15,528	220
21	"Hidroinvest 1" sh.p.k	248,758	98,627
22	"PURE ENERGY STEBLEVA" sh.p.k	15,000	40,000
23	"Malido-Energji" sh.p.k	45,480	16,873
24	"Termocentrali Vlore" sh.a.	20,000	40,000
25	KESH sh.a.	26,436,242	12,858,755
26	"Teodori 2003" sh.p.k	15,000	44,510
27	"Energji Ashta" sh.p.k	2,694,028	1,758,719
28	"Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k	335,752	258,870
29	"C & S Construction Energy" sh.p.k	376,914	173,094
30	"Hydro Energy" sh.p.k	186,729	130,865
31	"Wenerg" sh.p.k	112,515	76,696
32	"Koka & Ergi Energy Peshk" sh.p.k	148,627	75,570
33	"Ansara Konçension" sh.p.k	17,711	2,220
34	"Energy Plus" sh.p.k	395,056	257,229
35	"Hec Vluse" sh.p.k	207,950	207,026
36	"Energy partners Al" sh.p.k	176,544	153,127
37	"Hec Dunice" sh.p.k	15,000	40,000
38	"Korkis 2009" sh.p.k	15,550	2,711
39	"Ferar Energy" sh.p.k	15,000	40,000
40	"Hec-i Dragoshtunje" sh.p.k	15,000	40,000
41	"HP OSTROVICA" sh.p.k	196,424	96,161
42	"Hidropower Elektrik" sh.p.k	15,000	27,459
43	"DN & NAT Energy" sh.p.k	30,564	12,674
44	"Selishte" sh.p.k	74,826	25,522
45	"Idro Energja Pulita" sh.p.k	76,126	56,602
46	"Bekim Energjitik" sh.p.k	53,966	20,819
47	"Erald Energjitik" sh.p.k	30,597	24,039
48	"ERMA MP" sh.p.k	56,113	21,839
49	"Dosku Energy" sh.p.k	40,492	12,860
50	"DITEKO" sh.p.k	89,893	275,734



Nr.	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2016 (lekë)	Pagesa Rregullatore 2017 (lekë)
51	"Hec Lanabregas" sh.a.	341,364	209,971
52	"Kurum International" sh.a.	3,701,867	2,505,720
53	"Hydro Salillari Energy" sh.p.k	15,000	10,840
54	"Peshku Picar 1" sh.p.k	20,246	2,851
55	"Albanian Power" sh.p.k	244,075	125,301
56	"Hydro power Plant Of Korca" sh.p.k	134,622	84,397
57	"Henz Energji" sh.p.k	15,000	40,000
58	"Hydro Borshi" sh.p.k	125,728	65,875
59	"Lu & Co Eco Energy" sh.p.k	23,250	5,012
60	"Energo – Sas" sh.p.k	276,159	156,546
61	"Snow Energy" sh.p.k	69,482	44,276
62	"Stravaj Energji" sh.p.k	94,810	90,070
63	"Gjo Spa Power" sh.p.k	430,236	328,979
64	"Erdat Lura" sh.p.k	424,100	279,802
65	"E.T.H.H." sh.p.k	40,614	31,074
66	"Rej Energji" sh.p.k	15,000	40,000
67	"SA-GLE Kompani" sh.p.k	32,773	9,023
68	"Caushi Energji" sh.p.k	35,464	10,385
69	"Energji Xhadi" sh.p.k	25,787	7,165
70	"DUKA T2" sh.p.k	15,000	9,053
71	"Tucep" sh.p.k	25,257	6,812
72	"TRUEN" sh.p.k	15,000	32,882
73	"Hec-Treske" sh.p.k	78,341	66,342
74	"Hidro Energy Sotire" sh.p.k	68,722	39,484
75	"Shutina energji" sh.p.k	23,786	12,369
76	"Hec Cangonj" sh.p.k	15,000	40,000
77	"Zall Herr Energji 2011" sh.p.k	55,884	21,655
78	"Hec Qarr & Kaltani" sh.p.k	69,939	28,547
79	"Bardhgjani" sh.p.k	15,000	26,121
80	"Gjoka Konstruktion Energji" sh.p.k	100,757	49,834
81	"MTC Energy" sh.p.k	94,768	54,571
82	"EN Rel Hydro" sh.p.k	15,000	40,000
83	"Gurshpat Energy" sh.p.k	75,353	55,627
84	"Bistrica 3 Energy" sh.p.k	37,212	59,140
85	"Gjure Rec" sh.p.k	15,000	25,147
86	"SA'GA-MAT" sh.p.k	15,000	42,175
87	"Hidropowerplant Construction" sh.p.k. (Komp Energji)	44,476	30,369
88	"UKKO" sh.a.	15,000	13,076
89	"Fatlum" sh.p.k	17,186	3,791
90	"Ayen As Energji" sh.a.	236,394	321,822
91	"Koxheri Energji" sh.p.k	15,000	40,000
92	"Euron Energy" sh.p.k	413,435	296,152
93	"Alb-Energy" sh.p.k	811,870	363,926
94	"Energal" sh.p.k	15,000	136,373
95	"Kisi-Bio-Energji" sh.p.k	31,276	38,695
96	"Gama Energy" sh.p.k.	15,000	69,728
97	"Hec Kabash Porocan" sh.p.k	15,000	40,000
98	"Lengarica & Energy" sh.p.k	30,476	284,565
99	"Mesopotam Energy" sh.p.k	18,197	20,358
100	"Denas Power"	15,000	40,000



Nr.	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2016 (lekë)	Pagesa Rregullatore 2017 (lekë)
101	"Strelca Energy" sh.p.k	18,531	42,655
102	"HP Ujaniku Energy" sh.p.k	15,000	29,805
103	"C & S Energy" sh.p.k	15,000	164,873
104	"Nishova Energy" sh.p.k	15,000	8,402
105	Perparimi SK sh.p.k	15,000	12,251
106	Dragobia Energy sh.p.k	15,000	40,000
107	Ballenja Power Martanesh sh.p.k	15,000	119,654
108	Hec Lashkiza sh.p.k	15,000	40,000
109	Liria Energji sh.p.k	15,000	40,000
110	Devoll Hydropower sh.a.	15,000	230,819
111	Reka Energy sh.p.k	15,000	40,000
112	Gavran Energy sh.p.k	15,000	92,400
113	Prell Energy sh.p.k	15,000	40,000
114	XHENGU ENERGJI sh.p.k	15,000	40,000
115	DAAB ENERGY GROUP sh.p.k.	15,000	40,000
116	"M.C INERTE LUMZI" sh.p.k		40,000
117	"ENERGJI UNIVERS" sh.p.k		40,000
118	"Albtek Energy" sh.p.k		40,000
119	"SKATINË - HEC" sh.p.k		40,000
120	"EUROBIZNES" sh.p.k.		40,000
121	"THE BLUE STAR" sh.p.k		40,000
122	"AFRIMI K" sh.p.k		40,000
	Total I	43,166,008	25,640,000
II	Liçensë për ndërtim, instalim dhe prodhim	Pagesa Rregullatore 2016 (lekë)	Pagesa Rregullatore 2017 (lekë)
1	"Muso HEC Qyteze" sh.p.k	15,000	40,000
2	"Remi" sh.p.k	15,000	40,000
3	"Ers-08" sh.p.k	15,000	40,000
4	"E-Vento srl Albania" sh.p.k	30,000	40,000
5	"Albanian Green Energy" sh.p.k	30,000	40,000
6	"Hera" sh.p.k	30,000	40,000
7	"Union Eolica Albania" sh.p.k	30,000	40,000
8	"Alb Wind Energy" sh.p.k	30,000	40,000
9	"Biopower Green Energy" sh.p.k	30,000	40,000
10	"Enpower Albania" sh.p.k	30,000	40,000
	Total II	255,000	400,000
III	Liçensë për transmetim të energjisë elektrike/gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2016 (lekë)	Pagesa Rregullatore 2017 (lekë)
1	OST sh.a	8,350,439	4,526,898
2	"Albgaz" sh.a. (Gaz natyror)		40,000
	Total III	8,380,439	4,566,898
IV	Liçensë për shpërndarje të energjisë elektrike/gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2016 (lekë)	Pagesa Rregullatore 2017 (lekë)
1	"OSHEE" sh.a.	56,430,060	48,274,551
2	"Albgaz" sh.a. (Gaz natyror)		40,000
	Total IV	56,460,060	48,314,551



V	Liçensë për furnizim të energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2016 (lekë)	Pagesa Rregullatore 2017 (lekë)
1	"OSHEE" sh.a. (2 licensa furnizimi)	-	-
2	"Albpetrol" sh.a. (energji elektrike)	175,200	40,000
3	"GSA" sh.p.k	963,714	3,908,475
4	"GEN-I Tirana" sh.p.k	477,205	2,093,283
5	"EFT Albania" sh.p.k	749,362	40,000
6	"Energy Supply Al" sh.p.k	15,638	40,000
7	"Albanian Green Energy" sh.p.k	15,000	40,000
8	"Kurum international" sh.a 2 licencat	15,000	40,000
9	"Favina 1" sh.p.k	15,000	40,000
10	"Wonder" sh.a.	15,000	40,000
11	"Alpiq Energy Albania" sh.p.k	15,000	1,154
12	"AXPO Albania" sh.a.	22,675	40,000
13	"ERMA MP" sh.p.k	15,000	40,000
14	SNOW ENERGY sh.p.k	15,000	40,000
15	"AYEN Energy Trading" sh.a.	15,000	40,000
16	"Danske Commodities Albania" sh.p.k	15,000	40,000
17	"Ayen As Energji" sh.a.	15,000	2,196
18	"A&A GROUP" sh.p.k	15,000	155,767
19	"Noa Energy Trade" sh.p.k	15,000	40,000
20	"Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k	15,000	40,000
21	"Hidropower Elektrik" sh.p.k	15,000	40,000
22	"Future Energy AL" sh.p.k	15,000	40,000
23	"Devoll Hydropower" sh.a.	15,000	40,000
24	"Albanian Energy Supplier" sh.p.k	15,000	40,000
25	"Roberto Oil" sh.a.	15,000	38,973
26	"Gaca-Energjia alternative e gjelber" sh.p.k	15,000	40,000
27	"Electral" sh.p.k	15,000	40,000
28	"Lengarica & Energy" sh.p.k	15,000	40,000
29	Energjia D O O Veterniksh.p.k	15,000	1,005,550
30	Le Trading Albania sh.p.k	15,000	40,000
31	Dragobia Energy sh.p.k	15,000	40,000
32	Ballenja Power Martanesh sh.p.k	15,000	40,000
33	AE Distribution sh.p.k	15,000	897,773
34	"Phoenix Petroleum" sh.a. (Gaz Natyror)	15,000	40,000
35	XHENGGO ENERGJI sh.p.k	15,000	40,000
36	"Albanian General Electricity" sh.a		40,000
37	"Grid Energy" sh.p.k		40,000
38	"ALB ENERGY MARKET" sh.p.k		40,000
39	"Energy Financing Team Tirana" sh.p.k		40,000
	Total V	2,977,473	9,303,171



VI	Liçensë për tregtim te energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2016 (lekë)	Pagesa Rregullatore 2017 (lekë)
1	“GSA”sh.p.k	-	40,000
2	“Gen – I Tirana” sh.p.k	-	40,000
3	“Enpower Albania” sh.a.	15,000	40,000
4	KESH sh.a.	-	-
5	“Wonder Power” sh.a.	15,000	40,000
6	“EFT Albania” sh.p.k	-	975,379
7	“Axpo Group” sh.a.	-	82,123
8	“Alpiq Energy Albania” sh.p.k	15,000	40,000
9	Hydro Energy sh.p.k	15,000	40,000
10	“Energy partners Al” sh.p.k	15,000	40,000
11	“YLLIAD “ sh.p.k	15,000	40,000
12	“ENERGY PLUS” sh.p.k	15,000	40,000
13	“Energy Supply” sh.p.k	15,000	-
14	“Hec Vlushë”sh.p.k	15,000	40,000
15	“Hec Dragoshtunje”sh.p.k	15,000	40,000
16	“Hec Dunice” sh.p.k	15,000	40,000
17	“Erma MP”sh.p.k	15,000	40,000
18	“Diteko” sh.p.k	15,000	40,000
19	“Hec Lanabregas” sh.a.	15,000	40,000
20	“Hydro Salillari Energy”sh.p.k	15,000	40,000
21	“Albpetrol”sh.a.	15,000	40,000
22	“Malido Energji” sh.p.k	15,000	40,000
23	“Albanian Power” sh.p.k	15,000	40,000
24	“SNOW ENERGY” sh.p.k	15,000	40,000
25	“Stravaj Energji” sh.p.k.	15,000	40,000
26	“HP OSTROVICA” sh.p.k	15,000	40,000
27	“BINDI”sh.p.k	15,000	16,881
28	“Energji Ashta”sh.p.k	15,000	40,000
29	“Gjo Spa Power” sh.p.k	15,000	40,000
30	“Erdat Lura”sh.p.k	15,000	40,000
31	“Danske Commodities Albania”sh.p.k	20,168	793,264
32	“Rej Energji”sh.p.k	15,000	40,000
33	“Wenerg” sh.a.	15,000	40,000
34	“Henz Energy” sh.p.k	15,000	40,000
35	“A&A GROUP” sh.p.k	15,000	40,000
36	“Favina 1”sh.p.k	15,000	40,000
37	“WONDER”sh.a.	15,000	457
38	“TRUEN” sh.p.k	15,000	40,000
39	“A-91”sh.p.k	15,000	74,357
40	“Dans Energy Albania”sh.p.k	110,605	40,000
41	“Shutina Energji”sh.p.k	15,000	40,000
42	“Zall Herr energy 2011”sh.p.k	15,000	40,000
43	“Gjoka Konstruktion-ENERGY”sh.p.k	15,000	40,000
44	“EN-ERGY” sh.p.k	15,000	40,000
45	“Spahiu Gjanc” sh.p.k	15,000	40,000
46	“MTC Energy” sh.p.k	15,000	40,000
47	“Ayen Energy Trading” sh.a.	63,089	817,035
48	“EN Rel Hydro” sh.p.k	15,000	40,000
49	“Power Wind Energy” sh.p.k	15,000	40,000
50	“Gjure Rec” sh.p.k	15,000	40,000
51	“Bistrica 3 Energy” sh.p.k	15,000	40,000
52	“Ayen As Energji” sh.a.	15,000	40,000
53	“Power Trade Albania” sh.p.k	15,000	40,000
54	“Albanian General Electricity” sh.a.	50,739	40,000



VI	Liçensë për tregtim të energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2016 (lekë)	Pagesa Rregullatore 2017 (lekë)
55	"Antix" sh.p.k	15,000	40,000
56	"Emikel" sh.p.k	15,000	40,000
57	"Hidropowerplant Construction" sh.p.k.(Komp Energji)	15,000	40,000
58	"SA'GA-MAT" sh.p.k	15,000	40,000
59	"Le Trading Albania" sh.p.k	15,000	40,000
60	Kurum International (2 Liçensat e Ulez Shkopet dhe Bistrica)	15,000	3,053,512
61	"Noa Energy Trade" sh.p.k	25,741	468,194
62	"Power Elektrik Slabinje" sh.p.k	15,000	40,000
63	"Hidropower Elektrik " sh.p.k	15,000	40,000
64	"Fatlum" sh.p.k	15,000	40,000
65	"Future Energy AL" sh.p.k	17,431	114,621
66	"Devoll Hydropower" sh.a	15,000	375,210
67	"Albanian Energy Supplier" sh.p.k	15,000	40,000
68	Roberto Oil sh.a.	15,000	40,000
69	"Gaea-Energjia alternative e gjelber" sh.p.k	15,000	40,000
70	"Green Energy Trading Albania" sh.p.k	18,246	3,772
71	"Electral" sh.p.k	15,000	40,000
72	"Koxheri Energji" sh.p.k	15,000	40,000
73	"Energal" sh.p.k	15,000	40,000
74	"Euron Energy " sh.p.k	15,000	40,000
75	"Hec Kabash Porocan" sh.p.k	15,000	40,000
76	"Gama Energy" sh.p.k	15,000	40,000
77	"Kisi-Bio-Energji" sh.p.k	15,000	40,000
78	"Lengarica & Energy" sh.p.k	15,000	40,000
79	"Mesopotam Energy " sh.p.k	15,000	40,000
80	"Denas Power" sh.p.k	15,000	40,000
81	"HP Ujaniku Energy" sh.p.k	15,000	40,000
82	"Energjia D O O Veternik" sh.p.k	15,000	40,000
83	C & S Energy sh.p.k	15,000	40,000
84	Nishova Energy sh.p.k	15,000	40,000
85	Perpanimi SK sh.p.k	15,000	40,000
86	Dragobia Energy sh.p.k	15,000	40,000
87	Ballenja Power Martanesh sh.p.k	15,000	40,000
88	Hec Lashkiza sh.p.k	15,000	40,000
89	Liria Energji sh.p.k	15,000	40,000
90	AE Distribution sh.p.k	15,000	40,000
91	Nordic Invest Group sh.p.k	15,000	1,883
92	"Anio Oil & Gas" sh.p.k (Gaz Natyror)	15,000	40,000
93	"Phoenix Petroleum" sh.a. (Gaz Natyror)	15,000	40,000
94	Energy Market Albania sh.p.k.	15,000	40,000
95	DAAB ENERGY GROUP SH.P.K.	15,000	40,000
96	XHENGGO ENERGJI sh.p.k.	15,000	40,000
97	"M.C INERTE LUMZI" sh.p.k		40,000
98	"E N P I" sh.p.k		40,000
99	"Balkan Energy Trade" sh.p.k		40,000
100	"Grid Energy" sh.p.k.		40,000
101	"ALB-ENERGY" sh.p.k.		40,000
102	"ENERGJI UNIVERS" sh.p.k.		40,000
103	"ALB ENERGY MARKET" sh.p.k.		40,000
104	"PPC Albania" sh.a.		40,000
105	"Energy Financing Team Tirana" sh.p.k.		40,000
106	"ALIN TRADING" sh.p.k.		40,000
107	"ENERGY TO ENERGY" sh.p.k.		40,000
108	"THE BLUE STAR" sh.p.k.		40,000
109	"SMART Trade & Consulting" sh.p.k		40,000
110	"C.G.C" sh.p.k. (Gaz Natyror)		40,000
	Total VI	1,566,019	10,576,689
	TOTALI I PAGESAVE RREGULLATORE	112,805,000	98,801,309

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë